



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr. 08/2017

RREGULLA PËR FURNIZUESIN E MUNDËSISË SË FUNDIT

Prishtinë, 13 prill 2017

PËRMBAJTJA

RREGULLA PËR FURNIZUESIN E MUNDËSISË SË FUNDIT	3
KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi	3
Neni 2 Përkufizimet dhe Interpretimet	3
KREU II PROCESI PËR PËRZGJEDHJEN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT	5
Neni 3 Zgjedhja përmes konkurrencës	5
KREU III PËRSHTATSHMËRIA E TË LICENCUARVE PËR TË QENË FURNIZUES I MUNDËSISË SË FUNDIT	7
Neni 4 Kriteret e përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	7
Neni 5 Metodologjia për përcaktimin e çmimeve të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	8
KREU IV PARIMI I LLOGARITJES SË KOSTOS SË FURNIZIMIT	9
Neni 6 Llogaritja e kostos së furnizuesit të mundësisë së fundit	9
KREU V KRITERET E ZGJEDHJES DUKE NDJEKUR KONKURRENCËN	10
Neni 7 Pragu i pranueshmërisë	10
Neni 8 Zgjedhja e çmimit më të ulët	10
KREU VI TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT	11
Neni 9 Konsumatorët që kanë të drejtë të furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit	11
Neni 10 Obligimet e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	12
Neni 11 Obligimet Shtesë të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	12
Neni 12 Shërbimet e preferuara nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit	13
KREU VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	14
Neni 13 Ndryshimi	14
Neni 14 Interpretimi	14
Neni 15 Hyrja në fuqi	14

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, dhe Nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr.05/L-085, në seancën e mbajtur më 13 prill 2017, miratoi si në vijim

RREGULLA PËR FURNIZUESIN E MUNDËSISË SË FUNDIT

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

- 1 Kjo Rregull përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit i cili obligohet për të kryer shërbimin e Furnizimit të Garantuar sipas Nenit 39 dhe Nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
- 2 Më këtë Rregull do të përcaktohet:
 - 2.1 Procesin për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;
 - 2.2 Obligimet në lidhje me pranueshmërinë e të licencuarve për t'u caktuar Furnizues i Mundësisë së Fundit;
 - 2.3 Kriteret që do të përdoren për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit duke ndjekur një proces të konkurrimit;
 - 2.4 Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit; dhe
 - 2.5 Metodologjia për Përcaktimin e Çmimeve me të cilat Furnizuesi i Mundësisë së Fundit Furnizon konsumatorët me Energji Elektrike.

Neni 2

Përkufizimet dhe Interpretimet

- 1 Termat e përdorur në këtë Rregull dhe kanë kuptimet e si në vijm:
 - 1.1 **Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori)** - është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë;

- 1.2 **Furnizim i garantuar** - furnizimi i përkohshëm i konsumatorit fundor, të cilit, në raste të përcaktuara në këtë ligj i mundësohet furnizimi i përkohshëm me kufizimet e përcaktuara në këtë ligj;
 - 1.3 **Furnizues i mundësisë së fundit** - është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj konsumatorëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktjnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre;
 - 1.4 **Shërbimi universal i furnizimit** - e drejta e konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve ekonomike që punësojnë jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës dhe që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro që të furnizohen me energji elektrike të një kualiteti të caktuar me çmim të arsyeshëm, qartësisht të krahasueshëm, transparent dhe jo diskriminues;
 - 1.5 **Obligimet e Furnizimit të Shërbimit Universal** – do të thotë obligimet e Shërbimit Universal të vendosura në licencë.
 - 1.6 **Tarifa e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit** – do të thotë tarifa e ofruar nga furnizuesi për të mbuluar kostot e tij të arsyeshme për të siguruar furnizimin me energji elektrike për periudhën për sa është caktuar Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
 - 1.7 **Shërbimi i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit** – do të thotë shërbimi i Furnizimit të Garantuar i siguruar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
 - 1.8 **Kostot Direkte të Furnizimit me Pakicë** – do të thotë kostot administrative (që nuk lidhen me energjinë) që lidhen me marrjen e rolit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
- 2 Termet e përdorura në këtë Rregull do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorura në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë Termike dhe Ligjin për Gazin Natyror.

KREU II
PROCESI PËR PËRZGJEDHJEN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

Neni 3
Zgjedhja përmes konkurrencës

- 1 Rregullatori do të nxjerr vendim formal për hapjen e procedurës së tenderimit i cili do të përmbajë kriteret për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit, kushtet dhe afatet për furnizuesin e garantuar, informatat për formimin e çmimit dhe ndryshimet e tij, kushtet dhe afatet e kontratës si dhe kohëzgjatjen e periudhës për të cilën caktohet furnizuesi i mundësisë së fundit.
- 2 Në bazë të një procedure të hapur tenderimi, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit.
- 3 Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhë veprimi si furnizues i tillë prej tre (3) vitesh, sipas nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
- 4 Në rast se nuk zgjidhet furnizuesi i mundësisë së fundit në periudhën e përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, Rregullatori do të caktojë një furnizues që përkohësisht të ushtrojë funksionin e furnizuesit të mundësisë së fundit, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, periudhë kjo brenda të cilës do të zhvillohet tenderi i ri. Në rast se edhe tenderi i dytë dështon, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit me një akt të veçantë, duke përcaktuar të gjitha kushtet dhe afatet për vendosjen e obligimit të shërbimit publik në pajtim me nenin 5 të këtij ligji.
- 5 Vendimi i referuar në paragrafin 1 të këtij Neni, do të përcaktojë:
 - 5.1 kriteret për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, të cilat nuk do të bëjnë diskriminim në mes të operatorëve që kanë licencë për furnizim nga Rregullatori;
 - 5.2 kushtet e Furnizimit të Garantuar, ashtu siç përcaktohen në Nenet 10, 11 dhe 12 të kësaj Rregulle;
 - 5.3 kushti për të vepruar si Furnizues i Mundësisë së Fundit për një periudhë prej 3 vjeçare;
 - 5.4 Njoftimi për të dorëzuar një aplikacion nuk do të jetë më pak se tridhjetë (30) ditë.
- 6 Para kalimit të afatit të entitetit të caktuar si Furnizues i Mundësisë së Fundit, Rregullatori do të iniciojë një procedurë të re të tenderimit në mes të entiteteve të përshtatshme (për të shmangur dyshimin, duke mos përjashtuar të licencuarin aktual që është duke kryer shërbimin e tillë) për zgjedhjen e një të licencuari për të siguruar shërbimet e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për afatin e ardhshëm.

- 7 Procedura tenderimit e referuar në paragrafët 1 dhe 2 do të jetë në formë të ftesës për tender me shkrim të dorëzuar tek të licencuarit e përshtatshëm dhe që janë në dispozicion nga Rregullatori në aplikacion.
- 8 Rregullatori do të përcaktojë shkallën dhe metodat e publicitetit që do të aplikohen për të bërë të njohur procedurën e tenderimit për të licencuarit e përshtatshëm.
- 9 Dosja e tenderit do të hartohet nga Rregullatori dhe do të përmbajnë informatat e mëposhtme:
 - 9.1 Datat dhe kohët kur do të filloj procedura e tenderimit dhe procesi i dorëzimit të aplikacioneve si dhe koha dhe datat tjera që lidhen me procesin e konkurrimit;
 - 9.2 Shërbimet që kërkohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duke përfshirë fillimin e ofritit të shërbimeve për furnizim dhe afatin e tij;
 - 9.3 Metodologjia për përcaktimin e çmimeve që aplikuesi duhet të zbatojë në dorëzimin e tenderit;
 - 9.4 Karakteristikat e subjekteve të përshtatshme për të qenë Furnizues i Mundësisë së Fundit; dhe
 - 9.5 Rregullat që Rregullatori do të zbatojë në vlerësimin e tenderëve të dorëzuar .
- 10 Rregullatori do të informoj aplikuesit rreth vendimit për dështimin e caktimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në përputhje me procedurën e ofertimit të hapur, brenda 30 ditëve nga afati i fundit i dorëzimit të aplikacioneve.
- 11 Aplikuesi i pakënaqur me vendimin e Rregullatorit, për dështimin për të caktuar Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, do të ketë të drejtën e kundërshtimit brenda 30 ditëve në gjykatën kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi.

KREU III

PËRSHTATSHMËRIA E TË LICENCUARVE PËR TË QENË FURNIZUES I MUNDËSISË SË FUNDIT

Neni 4

Kriteret e përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

- 1 Konkurrenca për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të konsiderohet se është e vlefshme nëse jo më pak se dy (2) tenderues kanë përmbushur kriteret përkatëse të pranueshmërisë.
- 2 I licencuari i përshtatshëm për të qenë Furnizues i Mundësisë së Fundit duhet të jetë në gjendje të sigurojë dëshmitë e mëposhtme:
 - 2.1 Proceset administrative, teknologjisë informative, sistemet e faturimit dhe burimet e personelit me kapacitet për të transferuar numër të madh të llogarive të konsumatorëve në përgjegjësinë e vetë në mënyrë të saktë dhe në kohën e duhur;
 - 2.2 Proceset e auditimit operativ dhe financiar që janë në gjendje të identifikojnë se cilët konsumatorë janë shërbyer sipas kushteve të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe jo konsumatorët e kontraktuar në ndonjë mënyrë tjetër; dhe
 - 2.3 Kapacitetin financiar për të blerë energji elektrike të mjaftueshme shtesë për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve të cilët do të shërbehen nën Furnizuesin e Mundësisë së Fundit pa paragjykuar mundësinë e tij për të shërbyer konsumatorët tjerë për të cilët është kontraktuar.
- 3 Një i licencuar që dëshiron të jetë Furnizues i Mundësisë së Fundit duhet të garantojë që:
 - 3.1 Është i licencuar për të furnizuar të gjithë konsumatorët në Republikën e Kosovës, dhe furnizon konsumatorët të cilët furnizohen qoftë në tregun e Kosovës apo në ndonjë vend të Bashkimit Evropian ose në territorin e Palës Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë dhe përfaqëson së paku pesë (5) përqind të energjisë elektrike të konsumuar në atë treg;
 - 3.2 Do të shërbejë konsumatorët nën Furnizuesin e Mundësisë së Fundit në vazhdimësi për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditë dhe nuk do të ndër marrë asnjë masë për të shpëputur furnizimin e ndonjë konsumatori në bazë të shërbimit në fjalë para skadimit të asaj periudhe; dhe
 - 3.3 Do të ndihmojë të gjithë konsumatorët në kërkimin e tyre për një furnizues alternativ gjatë shërbimit gjashtëdhjetë (60) ditorë të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

Neni 5

Metodologjia për përcaktimin e çmimeve të Furnizuesi të Mundësisë së Fundit

- 1 Çmimi për grupe e ndryshme të konsumatorëve mund të ndryshoj vetëm deri në atë masë sa ndryshon profili i kërkesës së grupeve të konsumatorëve.
- 2 Për një periudhë kalimtare, Kostot Direkte të Furnizimit me Pakicë do të mbulohet nga Tarifa e cila aplikohet në nivel të transmetimit. Kostoja direkte apo përshtatjet e ngarkesës do të bëhen në bazë të parimit ex-post.
- 3 Tarifa e ngarkuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të përfshijë kostot e blerjes së energjisë me shumicë ndaj së cilës aplikohet një Margjine me Pakicë siç përcaktohet nga Rregullatori.
- 4 Kostot e jobalancës do të lejohen të mbulohen në kostot e blerjes së energjisë. Këto kosto do të ndahen në mes të konsumatorit dhe furnizuesit sipas Faktorit Ndarës të përcaktuar nga Rregullatori.
- 5 Margjina me Pakicë do të jetë një përqindje fikse e cila zbatohet në koston e energjisë elektrike të blerë. Ajo duhet të caktohet në një nivel të tillë që të:
 - 5.1 Sigurojë Furnizuesin e Mundësisë së Fundit me një kthim të arsyeshëm i cili kompenson atë për rreziqet që merr përsipër në sigurimin e shërbimit të Furnizimit të Mundësisë së Fundit. Kjo do të llogaritet duke iu referuar margjinës së fituar nga shërbimet e ngjashme në vendet tjera të Evropës, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato vende me atë të Kosovës; dhe
 - 5.2 Sigurojë Furnizuesit të Mundësisë së Fundit me një kthim të arsyeshëm në neto asetet fikse të tij të përdorura në sigurimin e shërbimit të Furnizimit të Mundësisë së Fundit. Kjo do të llogaritet duke iu referuar koston së kapitalit të të licencuarve të tjerë në Kosovë.
- 6 Margjina me Pakicë nuk do të kaloj normën prej 3%.
- 7 Konsumatorët e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të paguajnë tarifat përkatëse të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit si dhe të gjitha tarifat e aplikueshme të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes.
- 8 Kostot të cilat varen nga vëllimi i energjisë elektrike të furnizuar do të përcaktohen në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe do të reflektojnë koston reale të furnizimit e cila do të monitorohet nga Rregullatori në baza të rregullta.
- 9 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit mund të obligojë konsumatorët që të deponojnë një garancion bankar të barabartë me vlerën mesatare vjetore të dy (2) faturave të vitit paraprak.

KREU IV
PARIMI I LLOGARITJES SË KOSTOS SË FURNIZIMIT

Neni 6

Llogaritja e kostos së furnizuesit të mundësisë së fundit

- 1 Këto parime përcaktojnë mënyrën e llogaritjes së kostove të lejuara për të ofruar energji elektrike konsumatorëve të kualifikuar për furnizim të garantuar në Kosovë.
- 2 Kostot e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të llogariten sipas formulës në vijim:

$$SC_t = (RETR_t + WHPC_t + NTC_t)$$

Ku:

SC_t *Kostot e Furnizimit në Vitin Relevant t*

$RETR_t$ *Kostot me Pakicë në Vitin Relevant t*

$WHPC_t$ *Kostot e Blerjes së Energjisë në Vitin Relevant t*

NTC_t *Kostot e përdorimit të Rrjetit të Transmetimit dhe të Shpërndarjes në Vitin Relevant t*

Ku WHPC llogaritet sipas formulës në vijim:

$$WHPC_t = PPC_t + IMBC_t * IMBF_t$$

PPC_t *Kostoja e energjisë elektrike për ofrimin e Furnizimit të Mundësisë së Fundit e prokuruar në treg sipas parimeve të kësaj Rregulle*

$IMBC_t$ *Koston neto të jobalancit në Vitin Relevant t*

$IMBF_t$ *Faktori ndarës i jobalancit në vitin relevant t*

KREU V
KRITERET E ZGJEDHJES DUKE NDJEKUR KONKURENCËN

Neni 7
Pragu i pranueshmërisë

- 1 Të gjithë furnizuesit që dorëzojnë ofertën në ftesën për tender të cilët demonstrojnë respektim të kërkesave të specifikuara në Nenin 4 të kësaj rregulle dhe Kostot Direkte me Pakicë në përputhje me specifikat e përcaktuara në Nenin 5 të kësaj rregulle, do të konsiderohen se janë në përputhje me kushtet e tenderit dhe do të jenë të pranueshëm që të ofrojnë shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit nëse caktohen.
- 2 Çdo tender i dorëzuar që nuk konsiderohet se është në përputhje sipas paragrafit 1 ose pranohet me vonesë nga Rregullatori do të refuzohet dhe tenderuesi do të jetë i papranueshëm për të qenë Furnizues i Mundësisë së Fundit dhe do të informohet për këtë nga Rregullatori duke i dhënë arsyet për refuzimin e tenderit.

Neni 8
Zgjedhja e çmimit më të ulët

- 1 Rregullatori do të zgjedhë nga furnizuesit që konsiderohen si të pranueshëm, furnizuesin i cili ofron kostot direkte më të ulëta se ofertuesit e tjerë.
- 2 Kur Tarifa e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit është më ulët se 0.5 pikë përqindje mbi Tarifën e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të ofruar nga një furnizues tjetër, atëherë Rregullatori mund, por nuk është e obliguar, të zgjedhë furnizuesin që ofron Tarifën më të lartë të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit nëse Rregullatori beson se cilësia e shërbimit mund të jetë më e mirë në lidhje me Çmimet potencialisht të ofruara për konsumatorët e prekur në pajtim me Nenin 9 të kësaj Rregulle.

KREU VI
TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

Neni 9

Konsumatorët që kanë të drejtë të furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

- 1 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit i zgjedhur do të furnizoj konsumatorët që ngelin pa furnizuesin në rastet si në vijim:
 - 1.1 Furnizuesi i tyre ka bankrotuar apo është në procedurë të likuidimit;
 - 1.2 Licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, ose ka pushuar së vlejtori (skaduar);
 - 1.3 Konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.
- 2 Konsumatorët e referuar në paragrafin 1 të këtij neni, kanë të drejtë të shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për një periudhë jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.
- 3 Furnizuesi që nuk është në gjendje të furnizoj energjinë elektrike tek konsumatori i fundit në rastet e përcaktuara me paragrafin 1 nënparagrafin 1.1. të këtij neni, do të obligohet të njoftoj Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, konsumatorin fundor, Rregullatorin dhe operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes për datën suspendimit të furnizimit në kohë të duhur. Në këto raste konsumatori furnizohet nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- 4 Rregullatori do të informon Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, konsumatorët fundor, operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes për furnizuesin sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 të këtij neni, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data kur licenca në fjalë ka pushur të vlejë ose nga hyrja në fuqi e Vendimit të Rregullatorit për revokimin e përkohshëm apo përhershëm të licencës.
- 5 Në rast se konsumatori fundor nga paragrafi 1 nënparagrafi 1.3. i këtij neni që është furnizuar nga një furnizues i mundësisë së fundit, dështon të hyj në marrëveshje me furnizuesin e ri brenda periudhës së përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, operatori i sistemit do të ndërpresë furnizimin me energji elektrike.
- 6 Furnizimi i garantuar në rastet e përcaktuara nga paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 i këtij neni, do të filloj me ndërprerjen e kontratës me furnizuesin e mëparshëm ose kur furnizimi fillon për konsumatorin e ri, por që kontrata e furnizimit nuk është nënshkruar me ndonjë furnizues tjetër.

Neni 10

Obligimet e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

- 1 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë i obliguar që të siguroj të gjitha shërbimet e furnizimit të përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe në licencën përkatëse të lëshuar nga Rregullatori duke përfshirë (por duke mos u kufizuar në):
 - 1.1 Blerjen e energjisë elektrike me shumicë në emër të konsumatorëve të furnizuar sipas shërbimeve të Furnizimit të Garantuar dhe të jetë përgjegjës për balancimin e mbetjes me një furnizim të tillë me shumicë;
 - 1.2 Furnizimin dhe faturimin e konsumatorëve për periudhën e përcaktuar të furnizimit sipas dispozitave ligjore të kësaj rregulle;
 - 1.3 Informimin e konsumatorëve për kushtet e shërbimeve të ofruara; dhe
 - 1.4 Dorëzimin e kontratave të furnizimit tek konsumatorët që do të furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ka të drejtë të kërkoj që konsumatori i cili është nën shërbim të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të ofrojë garancion financiar për pagesë duke përfshirë parapagimet me kusht që ato kërkesa të jenë të arsyeshme, por Furnizuesi i Mundësisë së Fundit nuk ka të drejtë të ndërpresë shërbimin për konsumatorët në fjalë nëse nuk bëhen garancionet e tilla nga konsumatori gjatë periudhës së Furnizimit të Garantuar.

Neni 11

Obligimet Shtesë të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

- 1 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i obliguar të:
 - 1.1 Të njoftojë konsumatorin për kushtet dhe afatet e furnizimit dhe çmimet e energjisë elektrike;
 - 1.2 Të informojë konsumatorin për të drejtat e tij për ndërrim të furnizuesit;
 - 1.3 Dorëzojë kontratat tek konsumatorët përkatës brenda tetë (8) ditësh nga fillimi i furnizimit dhe jo domosdoshmërisht të dorëzojë kontrata të tilla para fillimit;
 - 1.4 Informoj konsumatorët e kualifikuar për Shërbimin Universal për mundësinë e furnizimit nga Furnizuesit me obligim të Shërbimit Universal (pavarësisht nëse një furnizues i tillë e ka atë obligim përmes Obligimit të Shërbimit Publik ose ndryshe) duke përfshirë edhe nëse Furnizuesi i Mundësisë së Fundit gjithashtu ka një Obligim të Shërbimit Universal të Furnizimit.
 - 1.5 Mirëmbajë dhe publikoj faqe të internetit me informata për konsumatorët rreth shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit duke përfshirë informatat rreth

numrit të konsumatorëve të furnizuar në shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit ndaras për konsumatorët familjar dhe jofamiljar, kohëzgjatjen mesatare të shërbimeve të tilla duke përfshirë detajet ndaras për konsumatorët të cilët janë të kualifikueshëm për Shërbime të Furnizimit Universal dhe ata që nuk janë të kualifikueshëm; dhe

- 1.6 Publikoj në faqen e vetë të internetit tarifat e furnizimit për muajt paraprak për kategori të ndryshme të konsumatorëve dhe vlerësimin e përafërt për tarifat e furnizimit të kategorive të konsumatorëve të cilët në të ardhmen (për të paktën një muaj) mund të furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- 2 Furnizues i Mundësisë së Fundit duhet të mbajë llogari të ndara për furnizimin e konsumatorëve sipas shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit nga furnizimi i konsumatorëve me drejtë të Shërbimit Universal dhe komercial. Këto të dhëna duhet ti ketë në dispozicion kurdo që ato mund të kërkohen nga ZRRE.
- 3 Furnizues i Mundësisë së Fundit duhet të ndihmoj konsumatorët të gjejnë një furnizues alternativ brenda 60 ditëve, por duhet të krijoj masat për ndërprerje të furnizimit për konsumatorët të cilët nuk bëjnë kontratë me një furnizues alternativ.
- 4 Furnizues i Mundësisë së Fundit duhet të mbajë kapitalin e nevojshëm për të siguruar se është në pozitë që të siguroj shërbimin e tillë.

Neni 12

Shërbimet e preferuara nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në interes të një tregu të rregullt të furnizimit me energji elektrike, pala që pranon obligimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit duhet të jetë në pozitë që të ofroj shërbime të furnizimit të arsyeshme dhe konkurrenente për konsumatorët e vetë për periudhë maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditëve për aq sa lejohet Furnizimi i Garantuar.

KREU VII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Ndryshimi

1. Rregullatori mban të drejtën që të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshim dhe modifikim të kësaj Rregulle, do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.


Neni 14
Interpretimi


Në rast të paqartësive për dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Bordi i Rregullatorit:


Krenar Bujupi, U.D Kryesues


Arsim Janova, Anëtar


Besim Sejfiqaj, Anëtar